VENDIM
Nr. 54, datë 3.5.2013

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT NR. 161, DATË 7.12.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të nenit 8 pika "b" dhe "ç" nenit 9 dhe nenit 26 ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

- Ekzistojnë paqartësi dhe pasiguri të treguesve kryesorë të llogaritjes së tarifës së energjisë elektrike për të gjitha aktivitetet e rregulluara;
- Shoqëria "CEZ Shpërndarje" operon me statusin në administrim të përkohshëm, situatë, e cila e bën të pamundur vendosjen e objektivave për treguesit e performancës;
- Aktualisht ERE me vendimet e datës 7.12.2011 ka aprovuar një tarifë mesatare trevjeçare për periudhën 2012-2014 për të gjitha aktivitetet e rregulluara, bazuar në mesataren e të ardhurave të kërkuara për të tria vitet;

Si dhe referuar situatës aktuale në sektorin e energjisë elektrike, e cila është e ngjashme për nga pamundësia e vendosjes së objektivave me situatën e vitit 2009, vit kur u mbyll procesi i privatizimit të 76% të aksioneve të kompanisë së shpërndarjes dhe ku ERE shtyu afatin e zbatimit të tarifave të vitit 2008 përgjatë vitit 2009 (vendimi nr. 7, datë 26 janar 2009).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të vendimit nr. 161, datë 7.12.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, deri në datën 31 dhjetor 2013.
2. Përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve të mundshme financiare në vitin pasardhës brenda së njëjtës periudhë rregullatore 2012-2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani